



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**AUTORITETI PËR INFORMIMIN MBI DOKUMENTET
E ISH-SIGURIMIT TË SHTETIT
SEKRETARIATI TEKNIK**

**UDHËZUES MBI SJELLJEN E PUNONJËSVE TË AIDSSH GJATË
FUSHATËS ZGJEDHORE, PËR ZGJEDHJET PËR KUVENDIN E
SHQIPËRISË, PRILL 2021**

Ku udhëzues është hartuar duke u bazuar në “Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë”; ligjin nr. 152/2013, “Për nëpunësin civil”, i ndryshuar; ligjin nr.10019 “Kodi zgjedhor i Republikës së Shqipërisë”; ligjin nr. 9131, “Për rregullat e etikës në administratën publike”; Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.9, datë 24.12.2020, *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror , kategorive e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”*, me qëllim për të lehtësuar kuptimin nga ana e punonjësve të AIDSSH të mënyrës se si duhet të veprojnë dhe të sillen gjatë periudhës së fushatës zgjedhore në raport me të drejtat dhe detyrimet e tyre.

Për t’i ardhur në ndihmë punonjësve të AIDSSH për mënyrën se si duhet të veprojnë dhe të sillen gjatë fushatës zgjedhore, Prill 2021, bazuar në legjislacionin e sipërpërmendur, në vazhdim janë disa përcaktime dhe shpjegime të përmbledhura për të drejtat dhe detyrimet e nëpunësve civilë në raport me fushatat zgjedhore, sikurse edhe si do të bëhet monitorimi i sjelljes së tyre gjatë fushatës zgjedhore, Prill 2021.

Ndjekja dhe zbatimi korrekt i tyre nga ana e punonjësve të AIDSSH, do t’i mbrojë ata nga shkeljet ligjore të mundshme, duke bërë të mundur edhe zbatimin e kërkesave të parashikuara në Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.9, datë 24.12.2020, *“Për rregullat e raportimit të veprimtarive me karakter publik të çdo institucioni publik, e me kapital shtetëror, kategorive e veprimtarive të ndaluara, si dhe monitorimin e veprimtarisë, sjelljes dhe*

përdorimit të burimeve njerëzore, financiare dhe logjistike të administratës shtetërore para zgjedhjeve”.

I - TË DREJTAT DHE DETYRIMET E NËPUNËSVE CIVILE APO ATYRE ME KONTRATË PUNE GJATË PERIUDHËS SË FUSHATËS ZGJEDHORE

1 – Pjesëmarrja e nëpunësve civile apo atyre me kontratë pune në organizime elektorale të subjekteve të ndryshme zgjedhore:

*“Nëpunësit civile apo punonjësit me kontratë pune nuk kanë asnjë pengesë ligjore të marrin pjesë në organizime elektorale të subjekteve të ndryshme zgjedhore **por**”:*

- **gjithmonë jashtë orarit zyrtar,**
- **dhe duke u kujdesur që të ushtrojnë vetëkontroll për sa i përket manifestimit në publik apo në rrjetet sociale të pikëpamjeve politike dhe besnikërisë në një forcë politike në jetën private (ç’ka do thotë që nëpunësit nuk mund të manifestojnë me pankarta në duar, apo të jenë protagonistë në foltoret e subjekteve politike që zhvillojnë fushatën zgjedhore),**

2 – Pjesëmarrja e nëpunësve civilë apo ata me kontratë pune në institucionet e ngritura për administrimin e procesit zgjedhor.

*“Nëpunësi civil apo ata me kontratë pune nuk ka asnjë pengesë ligjore që të ushtrojë veprimtarinë e tij, si pjesë e institucioneve të ngritura për administrimin e procesit zgjedhor **por** vetëm në kushtet kur:”*

- **ai është emëruar në përberje të tyre nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve,**
- **ai ka marrë autorizimin përkatës nga AIDSSH për këtë veprimtari.**

3 – E drejta e nëpunësve civilë apo atyre jashtë shërbimit civil për të kandiduar dhe për t’u zgjedhur.

*“Nëpunësi civil apo ai jashtë shërbimit civil ka të drejtë të kandidojë dhe të zgjidhet në zgjedhjet për Kuvendin e Republikës së Shqipërisë apo për organet e qeverisjes vendore, **por** në këto raste:”*

- nëpunësi civil apo ai jashtë shërbimit civil është i detyruar të kërkojë pezullimin nga detyra,
- institucioni (AIDSSH), zyrtarisht, duhet të miratojë pezullimin nga detyra.

II – MONITORIMI I SJELLJES SË NËPUNËSVE CIVILË APO ATYRE JASHTË SHËRBIMIT CIVIL GJATË FUSHATËS ZGJEDHORE, PRILL 2021.

Me qëllim monitorimin e sjelljes të punonjësve të AIDSSH gjatë periudhës zgjedhore bazuar në Vendimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve nr.9, datë 24.12,2020, me urdhrin nr. 5 , datë 13.01.2021 të Kryetares së AIDSSH, është krijuar Grupi i Monitorimit për rregullat e raportimin e veprimtarive me karakter publik të Autoritetit, si dhe monitorimin e sjelljes së burimeve njerëzore, financiare, logjistike, gjatë periudhës zgjedhore, për zgjedhjet për Kuvend, 25 Prill 2021”, me përbërje:

1. Skënder Vrioni	Sekretar i Përgjithshëm	Kryetar
2. Ardita Repishti	Drejtor i DMSHEQ	Anëtare
3. Mirela Lame	Përgjegjëse, Sektori Juridik dhe Prokurimeve	Anëtare
4. Vitori Fuqi	Përgjegjëse, Sektori i Financës	Anëtare
5. Florinda Rica	Përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore	Anëtare
6. Marjana Gorica	Përgjegjëse, Sektori i Logjistikës	Anëtare

Grupi i monitorimit ka hartuar rregulloren e brendshme ku veç të tjerave është përfshirë edhe procesi për mbikëqyrjen e sjelljes së punonjësve të AIDSSH gjatë periudhës së fushatës zgjedhore, prill 2021, si dhe dokumentacionin përkatës që punonjësit duhet të plotësojnë gjatë periudhës së fushatës zgjedhore.

Duke filluar nga data e miratimit të këtij udhëzimi, përveç detyrimeve që rrjedhin nga pjesa e parë (I) e këtij udhëzuesi, dokumentacioni që punonjësit e AIDSSH duhet të plotësojnë me qëllim që Grupi i Monitorimit të kryejë njërin nga elementet e monitorimit të sjelljes të tyre gjatë fushatës zgjedhore 25 mars-25 Prill 2021 do të jenë:

1 - Formulari i prezencës ditore të punonjësve:


INSTITUCIONI: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)

AKT KONSTATIMI

Në lidhje me situatën e administrimit të shërbimit civil, si edhe prezencën e nëpunësve civilë në institucion, në datën ____/____/2021, në kuadër të mbikëqyrjes së emërimeve të reja, largimit ose lirimit nga detyra, si edhe të siellies së tyre, gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet lokale, sipas tabelës në vijim:

(1) Nr.	(2) Nëpunësi civil (Emër/Mbiemër)	(3) Emërtesa e pozicionit të punës	(4) Prezenca në punë në orën 8:00 (Nëpunësit prezent nënshkruajnë individualisht Për nëpunësit që mungojnë shëno, arsyen)	(5) Kontroll i Grupit të Monitorimit Ora _____ (Nëpunësit prezent nënshkruajnë individualisht Për nëpunësit që mungojnë shëno, arsyen)	(6) Kontroll i Grupit të Monitorimit Ora _____ (Nëpunësit prezent nënshkruajnë individualisht Për nëpunësit që mungojnë shëno, arsyen)	(7) Përfundimi i orarit zyrtar të punës sipas institucionit. Ora 16:30/14:00 (Nëpunësit prezent nënshkruajnë individualisht Për nëpunësit që mungojnë shëno arsyen)
1						
2						
3						
4						

Grupi i Monitorimit

1. Skender Vrioni	<u>Sekretar i Përgjithshëm</u>	<u>Kryetar</u>
2. Ardita Repishti	<u>Drejtor i DMSHEQ</u>  (Ctrl) -	<u>Anëtar</u>
3. Mirela Lame	<u>Përgjegjëse, Sektori Juridik dhe Prokurimeve</u>	<u>Anëtar</u>
4. Vitori Fuqi	<u>Përgjegjëse, Sektori i Financës</u>	<u>Anëtar</u>
5. Florinda Rica	<u>Përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore</u>	<u>Anëtar</u>
6. Marjana Gorica	<u>Përgjegjëse, Sektori i Logjistikës</u>	<u>Anëtar</u>

1

Çdo ditë punonjësit duhet të plotësojnë orarin e ardhjes në punë (kolona 4) dhe orarin e largimit nga puna (kolona 7) duke venë firmat përkatëse.

Gjate ditës të punës, Grupi i Monitorimit do të kryejë kontrole të prezencës të punonjësve në vendet e tyre të punës dhe do të bëjë shënimet përkatëse në kolonat (5,6), duke firmosur në fund të çdo dite.

2 - Formularin e lëvizjeve ditore të punonjësve:

INSTITUCIONI: Autoriteti për Informimin mbi Dokumentet e Ish-Sigurimit të Shtetit (AIDSSH)						
Lëvizjet gjatë ditës të punës të nëpunësve civilë në institucion, në kuadër të monitorimit të sjelljes së tyre, gjatë periudhës së fushatës elektorale për zgjedhjet lokale, sipas tabelës në vijim					Date2021
Nr.	Nëpunësi civil (Emër/Mbiemër)	Ora e Daljes nga Zyra	Motivi/Destinacioni i daljes nga Zyra	Ora e Kthimit në Zyrë	Nënshkrimi i Nëpunësit	Nënshkrimi i Eprorit
Grupi i Monitorimit						
	Skender Vrioni			Kryetar		
	Ardita Repishti			Anëtare		
	Mirela Lame			Anëtare		
	Vitoria Fuqi			Anëtare		
	Floridna Rica			Anëtare		
	Marjana Gorica			Anëtare		

Çdo ditë, për ç’do levizje të punonjësve nga vendi i punës, jashtë zyrës, për arsye pune apo arsye të tjera, punonjësit duhet të bëjnë shënimet përkatëse në formular, duke firmosur në kolonën përkatëse, sikurse edhe eproret përkatës (*Sekretari i Përgjithshëm për punonjësit që nuk kanë epror*) duhet të konfirmojnë aprovimin e tyre për këto lëvizje, duke firmosur në kolonën përkatëse.

GRUPI I MONITORIMIT

- | | | | |
|----|-----------------|--|---------|
| 1. | Skënder Vrioni | Sekretar i Përgjithshëm | Kryetar |
| 2. | Ardita Repishti | Drejtor i DMSHEQ | Anëtare |
| 3. | Mirela Lame | Përgjegjëse, Sektori Juridik dhe Prokurimeve | Anëtare |
| 4. | Vitori Fuqi | Përgjegjëse, Sektori i Financës | Anëtare |
| 5. | Florinda Rica | Përgjegjëse, Sektori i Burimeve Njerëzore | Anëtare |
| 6. | Marjana Gorica | Përgjegjëse, Sektori i Logjistikës | Anëtare |

